



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I KOORDINIMIT, STUDIMEVE DHE INTEGRIMIT

Nr. 45/1 prot.

Tiranë, më 14.02.2025

Lënda: Kthim përgjigje.

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

TIRANË

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr.79 Prot., datë 07.01.2025, me të cilën kërkonte informacion të përditësuar për periudhën Janar-Dhjetor 2024, lidhur me hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, ju përcjellim informacionin si më poshtë:

- Nga të dhënat e Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme, që i përkasin periudhës një vjeçare Janar-Dhjetor 2024, rezulton se në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë kryer hetime për 54 procedime penale që lidhen me veprat penale në fushën e zgjedhjeve. Në këtë shifër përfshihen procedimet e mbartura nga viti 2023, një procedim i regjistruar i ri, të transferuara dhe rifillime të procedimeve të pezulluara. Procedimet janë në ngarkim të 16 shtetasve (persona nën hetim dhe të pandehur), prej të cilëve 1 me masë sigurimi "Arrest në burg".
- Procedimet janë regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 325, 326/1, 326/a-1, 327/1, 327/a-1, 328/a-1, 329/1, 330/1, 330/a-1 dhe 331 të Kodit Penal.
- Janë përfunduar hetimet për 23 procedime penale, nga të cilat janë pushuar hetimet për 14 procedime penale (me 5 persona nën hetim dhe 4 të pandehur), janë pezulluar hetimet për 2 procedime dhe janë kaluar për gjykim 7 procedime penale, me 10 të pandehur, njëri me masë sigurimi "Arrest në burg".
- Kohëzgjatja e hetimeve të procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e zgjedhjeve e të përfunduara, me persona nën hetim/pandehur, varion nga 9 deri 12 muaj. Kurse procedimet penale në proces hetimi kanë kohëzgjatje mbi 12 muaj.
- Përgjatë vitit 2024 kanë qenë në proces gjykimi 8 procedime penale (2 procedime të mbartura nga viti 2023 dhe 6 procedime kaluar për gjykim në vitin 2024). Ka përfunduar gjykimi për 5 procedime, me 16 të pandehur; si masa dënimi për shumicën prej tyre është aplikuar neni 59 i Kodit Penal "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove", një është dënuar me gjobë dhe një me burgim. Për një të pandehur është vendosur pafajësi dhe është ushtruar apel nga prokurori (nuk

ka të dhëna për shqyrtimin e çështjes në Apel). Vendimet e gjykatës kanë qenë në përputhje me kërkesën e prokurorit e si rrjedhim nuk ka pasur apeline të vendimeve.

- Në lidhje me të pandehurit dhe personat nën hetim (për të cilët ka përfunduar hetimi dhe që janë në hetim) rezultojnë 1 femër dhe 15 meshkuj, banues kryesisht në fshat dhe vetëm 4 prej tyre në qytet , me gjendje gjyqësore të pa dënuar, të grupmohave mbi 18 vjeç dhe me arsim të mesëm (vetëm dy janë një me arsim të lartë dhe një me arsim 9 vjeçar).

Ju falënderojmë për bashkëpunimin,

DREJTORI

Kostaq Beluri

